



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 295/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA për shkak të vendosjes së panove-banerit brenda hapsirave të shkollës në komunën e Mitrovicës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr 295/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA në të cilën thekson se në afërsi të shkollës Migjeni në qendrën e votimit 1102B në Mitrovicë monitoruesit e tyre kanë hasur në një pano reklamuese të kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA të ngjitur në hapësirë publike dhe në afërsi të shkollës më pak se 50 metra nga qendra e votimit. Parashtruesi i ankesës thekson se LZP, i ndalon këto veprime vendosja e poterave 100 metra distancë nga qendra e votimit, dhe si dëshmi ka bashkangjitur foto.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është shkolla fillore “Migjeni” dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të votuar si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 295/2017 më datën 13.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.